



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.370/22

GJYKATA KOMERCIALE - DHOMA E SHKALLËS SË DYTË, me gjyqtaren Saranda Bogaj Sheremeti, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), me nr. B...., nr, F.... -Inspektorati i Punës (I.P), me seli në Prishtinë-Rajoni i Ferizajit, kundër debitorit, me seli në Ferizaj, rr., me numër të biznesit, me pronar B.T. me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, PPP.nr.291/20, i datës;26.03.2021, me datë 01.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit, me seli në Ferizaj, rr., me numër të biznesit, me pronar B.T dhe VËRTETOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, PPP.nr.291/20, i datës;26.03.2021.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni, Civil, me aktvendimin PPP.nr.291/20, i datës; 26.03.2021, ka vendosur ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit, me seli në Ferizaj, rr., me numër të biznesit, me pronar B.T, i ushtruar kundër urdhrit të përmbartimor P.nr.494/20 dt.27.08.2020 dhe ka vendosur të mbetet në fuqi urdhri për lejimin e përmbartimit të përmbartuesit Besnik Aliu me seli në Ferizaj.

Kundër këtij aktvendimi me kohë ka parashtruar ankesë debitori për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta pranoj ankesën si të bazuar, dhe të merr një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori, edhe pse të njëjtën e ka pranuar me datën 01.04.2021.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës,

aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 dhe 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të vendimit të Inspektorit të Punës, me nr.150/20 i datës 08.05.2020 i formës së prerë me datë. 12.06.2020 dhe i ekzekutueshëm nga dt. 12.06.2020. Përmbartuesi privat Besnik Aliu, përmbartues në Ferizaj, sipas propozimit të kreditorit me urdhrin përmbartimor P.nr.494/20 dt.27.08.2020, ka lejuar përmbartimin duke vlerësuar se vendimi i Inspektoratit të Punës, me nr.150/20 i datës 08.05.2020, i plotëson kushtet si vendim përmbartues i dhënë në procedurë administrative.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 07.09.2020 me propozim që të aprovohet prapësimi i debitorit, ndërsa të lihet jashtë fuqie urdhri e përmbartuesit Privat P.nr.494/20 dt.27.08.2020. Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori, duke i propozuar gjykatës që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit dhe urdhri përmbartimor P.nr.494/20 dt.27.08.2020 i përmbartuesit Privat Besnik Aliu të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.291/20, i datës;26.03.2021, ka vendos që ta refuzoj prapësimin e debitorit i paraqitur kundër urdhrin përmbartimor P.nr.494/20 dt.27.08.2020.

Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur që kundërshtimin e debitorit ta refuzoj si të pa bazuar duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të ankimuar. Ka theksuar se përmbartimi është lejuar ne baze te dokumentit përmbartimor- aktvendimit të Inspektorit të Punës, me nr.150/20 i datës 08.05.2020,i formës së prerë nga data 12.06.2020, dhe i ekzekutueshëm nga data 12.06.2020, i cili i plotëson kushtet si dokument përmbartimor konform dispozitave nga neni 22 par 1 nën par 1.2 të LPP -së. Vendimi e saj gjykata e mbështeti edhe në nenin 5,22,70,71 dhe 73 të LPP –së.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK, dhe se drejtë

është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-ës.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se aktvendimi i lëshuar nga kreditori Inspektori i Punës me nr.150/20 i datës 08.05.2020, në rastin konkret është dokument përmbarues, kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-ës e cila dispozitë përcakton së: *“dokument përmbarues është edhe vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbarimit sipas nenit 21 duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragrafi 3 dhe 27 paragrafi 1 të po këtij ligji ku përcaktohet se: *“dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, andaj pretendimet ankimore të debitorit se gjykata ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së, me rastin e refuzimit prapësimi nuk qëndrojnë.

Në këtë rast Vendimi i lëshuar nga Inspektori i Punës me nr.150/20 i datës 08.05.2020 është dokument përmbarimor dhe i përmbarueshëm dhe cilësia e tillë i është konfirmuar me klauzolën e formës së prerë të datës 12.06.2020 dhe klauzolën e ekzekutueshmërisë të datës 12.06.2020 dhe si i tillë është i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarim, pasi që i njëjti i plotëson të gjitha kushtet, ku në të është treguar kreditori dhe debitori, është përcaktuar saktë lartësia e borxhit të debitorit, objekti, lloji, vëllimi dhe koha e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit. Po ashtu vendimi si dokument përmbarimor, ka cilësinë e titullit ekzekutiv dhe është i përmbarueshëm, pasi që i njëjti është i pajisur me klauzolën e formës së prerë dhe klauzolën për ekzekutueshmëri dhe si i tillë konform nenit 36 paragraf 1 dhe 2 të LPP-së, sipas këtij titulli përmbarimi në këtë rast është i lejuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet për mosplotësimin e kushteve për lejimin e përmbarimit sepse gjykata apo përmbaruesi privat në procedurë përmbarimore i përmbahet parimit të rigorozitetit formal juridik, nga i cili parim rrjedh se gjykata-përmbaruesi privat e vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbarimor, vlerëson nëse janë plotësuar kushte për nxjerrjen e urdhrit përmbarimor dhe në procedurën sipas prapësimi gjykata e shkallës së parë i vlerëson shkaqet e treguara në prapësim nga neni 71 i LPP-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes së përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE - DHOMA E SHKALLËS SË DYTË
K.DH.SH.II.nr.370/22, data 01.09.2022

Gjyqtarja

Saranda Bogaj Sheremeti